



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 26.12.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala 506

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje ishte prezent Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror në përbërje prej: Shpejtim Bulliqi, kryesues; Avdi Gjonbalaj, Florim Isufi, Hamit Basholli dhe Zejnullah Gruda, anëtarë.

Pjesëmarrësit e tjerë: Ali Lajçi, Ismajl Kurteshi, deputetë; Adem Gashi, Ambasada Amerikane; Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office; Nehat Dervishi, OSBE; Vlora Nushi, OPA/UNMIK; Gramoz Paçarada, KDI; Besmir Radoniqi, Fillesë Demaku, Egnesa Vitia, Leutrim Latifi, Valtrim Hasani, praktikantë dhe media.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Vjosa Osmani Sadriu i njoftoi të pranishmit se në takimin e kaluar të komisionit me kërkesë të deputetëve është vendosur që para se të procedohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi në seancë plenare, paraprakisht të ftohet për diskutim komisioni shtetëror i udhëhequr nga z. Shpejtim Bulliqi, dhe kryeministri i Republikës së Kosovës, i cili e ka proceduar këtë projektligj për Kuvendin e Kosovës. Nga kryeministri njoftoi se nuk kemi marrë ndonjë përgjigje zyrtare. Ajo falënderoi Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit për përgjigjen e tyre pozitive dhe pjesëmarrjen në këtë takim të përbashkët me komisionin.

Shpejtim Bulliqi, falënderoi komisionin për ftesën që u është bërë dhe mundësinë për paraqitjen e gjetjeve në raportin e përpiluar për nevojat e Qeverisë së Kosovës. Ai informoi se Qeveria e Kosovës me vendimin 01/06 të datës 03.10.2017 ka autorizuar Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror që të bëjë vlerësimin e punës së ish - Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror. Z. Bulliqi njoftoi se përkundër presioneve politike dhe mediatike të brendshme dhe të jashtme, si dhe afatit të kufizuar kohor komisioni ka arrit ta hartojë një raport preliminar dhe sikur të kishin pasur kohë të mjaftueshme kishin me pasur mundësi që të gjejnë edhe shumë fakte të tjera të cilat e dëshmojnë që vija kufitare e cila është ofruar nga ana e komisionit ka qenë me gabime dhe është përcjellë me gabime. Puna e këtij komisioni tha se ka qenë e orientuar në tri drejtime kryesore gjatë kësaj faze, e para ka qenë analiza e dokumentacionit të punës të cilën e ka ofruar ish -Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, e dyta puna në terren dhe orientimi i tretë ka qenë në hulumtimin e fakto-grafive të reja në institucionet vendase edhe ato ndërkombëtare që lidhen me çështjen e kufirit në mes Kosovës dhe Malit të Zi. Bëri të ditur se pas analizës së dokumentacionit Komisioni ka argumente se ish- komisioni ka tejkaluar kompetencat e tija sipas nenit 40 të Ligjit për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror, duke përcaktuar vijën e re të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit Zi pa një marrëveshje ndërkombëtare paraprake. Ish-komisioni ynë nuk ka bërë demarkacion as shënim të vijës kufitare, por ka bërë përcaktim të vijës kufitare sepse shënjimin dhe mirëmbajtja e vijës kufitare ose demarkacioni ka mbet të bëhet dy vite pasi të hyjë në fuqi kjo marrëveshje, tha z. Bulliqi. Të dhënat kadastrare që komisioni tani i ka marrë ekskluzivisht si kriter për përcaktimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, tha se janë të dhëna të vitit 1929, 1931, 1933 të pazbuluara asnjëherë më parë. Komisioni gjatë punës së tij është mbështetur në kontrollin efektiv, se kush ka menaxhuar në atë territor deri në një moment të caktuar dhe nga hulumtimet që i ka bërë në institucione të vendit e disa në institucione jashtë territorit të Kosovës, ka ardhur në përfundim se shumë objekte infrastrukturore të ndryshme në territorin që sot është diskutabil e ka menaxhuar Kosova. Kosova e ka menaxhuar rrugën, e ka ndërtuar rrugën, e ka shtruar asfaltin, e ka mirëmbajt rrugën, i ka bërë ato projekte, e ka kontrolluar atë territor në bazë të një shkresë që e kemi deri më dt. 12.01.2009, e cila shkresë zyrtare është nga ana e policisë së Kosovës, kur për herë të parë nga pala malazeze kërkohet që kompanitë tona, tash e tutje mos ta mirëmbajnë atë rrugë të cilën e ka mirëmbajtur thuajse 67 vite, shpjegoi z. Bulliqi. Duke pasur parasysh të gjitha këto vijmë në përfundim se vija administrative e KSAK-së, e krahinës së hershme të Kosovës nuk është identike me vijën kufitare të cilën e ka prodhuar Komisioni ynë shtetëror, tha ai.

Zejnullah Gruda, mes tjerash në fjalën e tij, tha se është e padiskutueshme se në këtë rast është bërë një punë në mënyrë tejet joprofesionale, tejet e papërgjegjshme, tejet e gabueshme, nga se që nga fillimi Komisioni shtetëror i kryesuar nga z. Meha janë marrë me një punë që

nuk ka qenë punë e tyre. Në momentin kur ka filluar punën komisioni i përbashkët me malazez është parë qartë se dy komisionet kanë fushëveprim të ndryshëm ose janë të autorizuar me punë të ndryshme. Më e keqja është se Komisioni shtetëror i kryesuar nga z. Meha kanë bërë një punë që nuk kanë guxuar ta bëjnë dhe që me rregulla normale do të kishte nxitur edhe përgjegjësi nga ata që bëjnë punë të pa thirrur dhe të paautorizuar, siç është pranimi i një kriteri të panjohur në të drejtën ndërkombëtare, atij kadastror.

Hamit Basholli bëri të ditur se delimitimi i kufirit është një proces teknik dhe vendimmarrës në mënyrë që marrëveshja e cila bëhet siguron që të jetë një marrëveshje e cila mundet të shënohet në terren pa dykuptimësi, pa ambiguitet dhe pa vështirësi dhe shpjegoi fazat nëpër të cilat kalon ky proces. Ai tha se në punën e tyre si komision janë fokusuar në çështje teknike – juridike, por më tepër në analizimin e të dhënave kadastrave për kufijtë. Kufijtë e kadastrës janë kryesisht çështje brenda rregullimit të brendshëm të një territori administrativ dhe në këtë rast kufijtë administrativë politik i mbi vendosen çdo herë kadastrat. Në kadastrën e zonës së Pejës buzë kufirit me Malin e Zi kanë ekzistuar rajonet apo banovinat dhe kanë administruar me një pjesë të Kosovës që tani përkon me kufirin e tanishëm me Malin e Zi, që tregon se ky kadastrë që sot e ka Kosova, gjegjësisht Peja është krijuar në kohën e banovinës që ka pasur për qëllim sigurimin e pronave për kishën ortodokse dhe kolonizimin e kësaj pjese. Njoftoi se ish- Jugosllavia në vitin 1946 ka shpallur të pavlefshme të gjitha ligjet e rregulloret e kohës, që janë marrë para dt. 6 prill 1941. Z. Basholli më tej tregoi në mënyrë kronologjike se nga këto banovina është krijuar Kosova e Mali i Zi, e më pas në vitin 1945 është themeluar Mali i Zi, si Republikë Popullore. Rajoni i Pejës në vitin 1945 ka pasur kadastrë të trashëguar, ndërsa në vitin 1953 me një dekret të kadastrës së tokave kërkohet që kufijtë dhe kadastra të shtrihen dhe të përshtaten me kufijtë administrativë. Në vitin 1984 ka një mbulueshmëri të kadastrës të Kosovës, përveç rajonit të Pejës i cili mbetet me kadastrën e banovinave. Në vitin 1984-85 tha se nuk ka të dhëna nga arkivi dhe rajoni i Pejës mbetet me kadastrën e banovinave të ish- Jugosllavisë që d.m.th. nuk ka kadastrë të ri të punuar në këtë pjesë. Ai njoftoi se edhe Mali i Zi në definimin e kufirit me Bosnje e Hercegovinën nuk e pranon kadastrën e krijuar, i cili nuk ishte kadastrë i banovinave por thirren në procesverbalet e përkufizimit të kufijve administrativ, e jo në kadastrë.

Vjosa Osmani Sadriu kërkoi nga anëtarët e komisionit shtetëror që të fokusohen ndër të tjera edhe në pretendimet e dëgjua më parë nga ata, se Komisioni shtetëror i kryesuar nga z. Meha ka bërë ndërhyrje në disa harta që rrjedhimisht rezulton me falsifikimin e tyre, tha ajo.

Florim Isufi theksoi se nëse në një proces ekzistojnë dy vija, njëra e kadastrave dhe tjetra vija administrative, sipas të drejtës ndërkombëtare rëndësi i jepet kontrollit efektiv, që është administrim i hapësirës. Gjatë dy viteve të fundit tha se jemi marrë me kontrollin efektiv dhe nuk është gjetur asnjë dokument nga Malin e Zi që e ka kritikuar Kosovën, se përse i kontrollon ato territore. Në këtë drejtim z. Isufi njoftoi për një aksident të ndodhur në vitin 1981 në Qafën e Çakorrit, të një autobusi nga Mali i Zi dhe gjithë procedura lidhur me aksidentin tha se është kryer nga sistemi i drejtësisë së KSAK-së. Ky aksident ka ndodhur në kthesën e tretë te Qafa e Çakorrit që le të kuptohet se kontrolli efektiv i territorit në mes të këtyre dy kufijve ka qenë i administruar nga strukturat e KSAK-ës, pas vitit 1974 gjegjësisht në vitin 1981. Raste të kontrollit efektiv nga Kosova në pjesën e kontestuar të kufirit përmendi edhe rastin kur në vitin 1960 institucionet e Serbisë për veprimet e tyre në këtë zonë nuk marrin leje nga Mali i Zi, por nga pala kosovare, si dhe rastin në pjesën veriore të Pejës deri në Kullë ku pas vitit 1974 nga organet e KSAK-ës merret vendimi në Prishtinë për ndërtimin e rrugës për Rozhajë, e jo në Titogradin e atëhershëm. Ai theksoi se nuk kanë gjetur asnjë dokument që pala malazeze ka kundërshtuar këto veprime të lartpërmendura.

Aida Dërguti duke theksuar se mospjesëmarrja e Qeverisë në këtë takim është jo serioze ajo pyeti se pse është proceduar në Kuvend raporti preliminar dhe se kur ky komision planifikon të përpilojë raportin përfundimtar.

Vjosa Osmani Sadriu fillimisht pyeti komisionin lidhur me tejkalimin e kompetencave sipas nenit 40 të Ligjit për shënimin e kufirit se, nëse ka pas tejkalim a eliminohet ky problem në momentin kur Qeveria e autorizon një tejkalim të tillë sepse ky autorizim tashmë ka ndodhur, tha ajo. Lidhur me vendimin e arbitrazhit në mes të Kroacisë e Sllovenisë përkundër pretendimeve të Kroacisë për disa pika kontestuese, Tribunali ka vendosur t'i marrë për bazë të dhënat e viteve të 29-ta të banovinës nga se ato e kanë paraqitur në mënyrë më të saktë kufirin në mes të dy shteteve. Pyeti se si është e mundur që arbitrazhi të merr parasysh të dhëna nga viti 1929-33 pasi që u përmend se ekziston ligji i vitit 1946 me të cilin ish- Jugosllavia anulon të gjitha ligjet e rregulloret e nxjerra para dt. 6 prill 1946. Në argumentet e Komisionit sipas të cilave u tha se Kosova ka menaxhuar pjesë të caktuara të territorit, pyeti se a ka pas pjesë që ka menaxhuar Mali i Zi, ndërsa tani në bazë të marrëveshjes së nënshkruar i takojnë Kosovës. Znj. Osmani Sadriu ritheksoi nevojën që dikush nga anëtarët e Komisionit shtetëror të njoftojë qartë se a ka pasur ndërhyrje të Komisionit të kryesuar nga z. Meha në hartat që janë përdorur si dëshmi në atë komision. Duke u ndërlidhur me vendimin e Tribunalit të arbitrazhit në mes të Sllovenisë e Kroacisë, tha se me të drejtë flitet për vendimin për marrjen e kriterit kadastror për përcaktimin e kufirit nëse palët janë pajtuar që ai kriter të merret parasysh, por jo apriori të jetë kriter ekskluziv. Nga Komisioni shtetëror i kryesuar nga z. Meha tha se kemi dëgjuar se ka përpuntje të përpiktë në mes të dhënave kadastrave të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës, pyeti se a janë ato ngastra kadastrave apo lista poseduese që i ka afuar Mali i Zi për të dëshmuar se ka të dhëna kadastrave deri te Kulla dhe Çakorri apo akoma pretendoni se Mali i Zi nuk ka ofruar të dhëna kadastrave për të dëshmuar që ajo pjesë e territorit i takon atyre.

Shpejtim Bulliqi theksoi se ka qenë e nevojshme që Qeveria t'ua japë edhe pak kohë që raporti të kompletohet edhe më tej me faktografi, por meqë është kërkuar raporti me urgjencë është dashur që komisioni ta ndërpresë punën dhe ta rrumbullakojë atë me faktet që i ka pasur në dispozicion. Ai tha se janë komision i përhershëm dhe se janë duke e vazhduar punën për çfarëdo sfide që mund t'i pret institucionet tona.

Florim Jusufi theksoi se dokumentacionin origjinal të hartave nuk e kanë pasur, por raportet e Komisionit për shënimin edhe mirëmbajtjen e kufirit të cilat kanë qenë të publikuara në web të Qeverisë. Materiali i tëri është analizuar dhe ka gjetje se ka intervenime në hartat origjinale, shtoi ai. Nga projektori z. Jusufi shpjegoi se një vijë ngjyrë kafe në të kuqe është vendosur mbi hartën origjinale, e cila ka të bëjë me kufirin sipas marrëveshjes. Harta origjinale nuk e ka kufirin dhe se ky kufi është i vendosur nga dikush. Hartat të cilat nuk kanë kufi tha se, nuk ka pasur nevojë të hyjnë në bisedime dhe se kanë qenë të tepërta në material. Bëri të ditur se ka harta origjinale me kufi, por ato nuk janë përdorur. Janë 4 harta nga të cilat 3 e kanë kufirin, ndërsa 1 nuk e ka dhe quhen Peja 1, Peja 2, Peja 3 dhe Peja 4. Ai shtoi se në material është prezantuar vetëm një hartë e Pejës e cila nuk dihet nga ka ardhur me disa vula që prezantojnë disa institucione të sigurisë dhe të institucioneve të tjera të SHBA-së. Theksoi se nuk e din se kush ka luajtur me këta kufij dhe se cili ka qenë qëllimi i prezencës së hartave që nuk kanë kufij. Duke u përgjigjur në pyetjet se a ka pjesë të menaxhuara nga Mali i Zi, e që tani mbeten në territorin e Kosovës, tha se ka një territor i cili është shumë i vështirë për qasje.

Zejnullah Gruda tha se Komisioni për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror ka bërë keqpërdorimin e parë me tejkalimin e kompetencave të tija. Rezultati final është marrëveshja

për kufirin, e nuk është për demarkacionin e kufirit. Demarkacioni i kufirit do të bëhet 2 vjet pasi të hyjë në fuqi kjo marrëveshje, dhe shtoi se problemet territoriale, janë në kompetencë të Kuvendit që është sovran i shtetit dhe i kombit. Nëse paraqitet tejkalmi i kompetencave të Komisionit, Kuvendi i çdo shteti ka të drejtë ta refuzojë marrëveshjen për arsye të justifikuara sipas së drejtës ndërkombëtare, tha ai. Arsye e justifikuar është tejkalmi i kompetencave dhe se është e qartë se në vend se të bëhet demarkacioni i kufirit është bërë demilitimi i kufirit, e i cili është bërë keq ngase janë mbështetë në një parim që nuk është i njohur në të drejtën ndërkombëtare. Ai në vazhdim theksoi edhe arsyet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare, sipas të cilave Kuvendi i çdo shteti ka të drejtë të refuzojë ratifikimin e një marrëveshjeje.

Vjosa Osmani Sadriu, duke përmendur se neni 47 i Konventës së Vjenës i parasheh rastet kur një komision gjatë negociatave i tejkalon kompetencat, e në këtë rast në vend se të bëhet vetëm demarkacioni e jo demilitimi, tha se është dashur që Qeveria e Kosovës para dhënies së pajtimit të vet ta njoftojë Qeverinë e Malit të Zi, që ka pasur tejkalm të kompetencave nga Komisioni shtetëror. Ajo tha se Qeveria e Kosovës duke e proceduar këtë marrëveshje, juridikisht e ka pranuar tejkalimin e pretenduar të kompetencave dhe e ka vënë Kuvendin para një situatë, ku e miraton atë tejkalm dhe të njëjtën kohë i procedon 2 raporte të komisioneve atë nga z. Meha dhe nga z. Bulliqi.

Shpejtim Bulliqi tha se puna e komisionit është punë profesionale, ndërsa çështja e marrëveshjes duhet të diskutohet në mes të Kuvendit dhe Qeverisë.

Zafir Berisha vuri në pah se, deputetët para një të vërtete të vetme gjenden para dy të vërtetave profesionale dhe në këtë drejtim pyeti se a ekziston mundësia që në mes të dy komisioneve të gjendet një mes. Ai tha se janë për një zgjidhje, por jo për ta dëmtuar Kosovën, prandaj pyeti nëse ekziston mundësia që të punojnë bashkë të dy komisionet dhe të mos dëmtohet askush.

Doruntina Maloku duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Bulliqit, se të gjitha dëshmitë janë marrë nga institucionet relevante ndërkohë pas publikimit të raportit tha se Agjencia Kadastrore e Kosovës ka reaguar nga se në faqe 53 të raportit është thënë se një pjesë e madhe e materialit gjendet në Serbi, pyeti komisionin nëse ka ndonjë kundër reagim ndaj agjencisë.

Shpejtim Bulliqi lidhur me pyetjen e deputetit z. Berisha theksoi se gjithnjë ka mundësi për zgjidhje të kësaj çështjeje dhe se ka pasur angazhime nga deputetë të Kuvendit në këtë drejtim, por nuk ka pasur suksese. Ne duhet të bëjmë përpjekje për gjetur një zgjidhje tha ai e cila nuk e cenon integritetin territorial dhe e zhbllkon procesin. Ndërsa sa i përket Agjencisë Kadastrore të Kosovës tha se agjencia nuk ka të drejtë të përzihet në çështjet e Komisionit.

Zejnullah Gruda shtoi se në të drejtën ndërkombëtare nuk ka ratifikim të pjesshëm të marrëveshjes, marrëveshja ose duhet të miratohet ose të refuzohet.

Hamit Basholli tha se nuk mund të ketë rezerva në marrëveshje dypalëshe ngase vërja e rezervave krijon propozim të ri për marrëveshje me shtetin tjetër. Kufiri tha se tani ka zbritur nga 1549 m lartësi mbidetare në 1040 m dhe për këtë duhet shpjegim.

Doruntina Maloku pyeti nëse komisioni i ka marrë të dhënat nga Agjencia e Kadastrore, të cilat ata pretendojnë se i kanë nga viti 1930.

Hamid Basholli njoftoi se të dhënat kadastrare nga vitet e 30-ta ekzistojnë në kadastrën e Pejës, ndërsa të dhënat nga viti 1984-85 tha se nuk i kemi. Lidhur me të dhënat kadastrën, tha

se ato ndryshojnë nga vendi në vend si në Slloveni, Kroaci një pjesë të Bosnjës e një pjesë të Malit të Zi varësisht nga historia.

Time Kadrijaj mes tjerash tha se kjo temë është duke u trajtuar që gati dy vjet dhe vetëm njëherë është përcjellë për shqyrtim në Kuvend dhe atëherë është tërhequr nga shqyrtimi. Ajo falënderoi Komisionin për punën profesionale dhe kryeministrin për raportin me qëllim që deputetët të kenë argumente shtesë për atë që ka ndodhur. Znj. Kadrijaj theksoi se tani është kuptuar se me këtë marrëveshje ka shkelje në kriteret e vendosjes së kufirit dhe fakte në çështjen e aksidentit të cilën e solli komisioni, si dhe fakti i administrimit të rrugëve në periudhën e pasluftës, mirëmbajtja e asfaltimi i rrugës, për të cilat duhet gjetur një zgjidhje.

Visar Ymeri e vlerësoi të gabuar nga Qeveria aktuale mos veprimin e menjëhershëm ndaj faktit të komisionit aktual për tejkalimin e kompetencave nga komisioni paraprak. Është dashur tha ai të njoftohet Mali i Zi se është konstatuar tejkalimi i kompetencave dhe se rrjedhimisht kjo marrëveshje nuk mund të merret për bazë. Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës është Republikë Parlamentare, ku Kuvendi i saj vendos nëse një pjesë e territorit do t'i jepet ose do t'i merret një shteti, do të duhej që këtë marrëveshje të mos e ratifikoj, por të kërkoj nga Qeveria që ta përmirësojë gabim e saj dhe ta konstatojë zyrtarisht. Ai pyeti komisionin se duke pasur parasysh gjendjen në të cilën jemi dhe dokumentet të cilat e kemi, cili mendon se do të ishte epilogu i kësaj marrëveshjeje në arbitrazh. Z. Ymeri po ashtu pyeti komisionin aktual se a ka vërejtur nga trajtimi i punës së Komisionit paraprak dhe procesverbaleve që i kanë paraqitë se cili ka qenë momenti kur ky komision e ka ndryshuar qëndrimin karshi vijës kufitare, apo e ka pasur të njëjtin qëndrimin vazhdimisht apo nuk ka pasur qëndrim fare. Çështje tjetër z. Ymeri ngriti lidhur me dokumentet që janë përfol, se është një dokument i Qeverisë së Kosovës përkatësisht i MPB i cili urdhëron policin e Kosovës që të zhvendoset diku 3-4 km brenda territorit të Kosovës në vitin 2009, për të cilin pyeti se a është gjetur ky dokument dhe a është konstatuar se është nxjerrë nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht MPB.

Ismajl Kurteshi theksoi se në monografinë për Kosovën nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës në vitin 2011, pos tjerash përshkruhet edhe kufiri i Kosovës dhe Malit të Zi. Ai pyeti se në çka është bazuar Akademia për përcaktimin e kufirit në kadastrë apo në ndonjë burim tjetër të informimit dhe se a është ajo vijë kufitare në përputhje me të gjeturat e komisionit aktual apo me ato të komisionit paraprak të udhëhequr nga z. Meha. Z. Kurteshi tha se nëpër media thuhet se komisioni shtetëror i kryesuar nga z. Meha ka falsifikuar dhe ka fshehur dokumente, pyeti se a është e vërtetë dhe se komisioni aktual a ka gjetur ndonjë dokument të falsifikuar apo të fshehur të cilin e kanë pasur në dorë dhe nuk e kanë shfrytëzuar për të përcaktuar kufirin atje ku është.

Ali Lajçi, lidhur me kriterin e kadastrës tha se kadastra dhe kufiri nuk mund të përputhen, sepse kufijtë shtetëror i përcakton kufiri administrativ shtetëror, kurse kufijtë kadastrorë janë kufij komunal. Z. Lajçi ceku se është bërë vijë e re kufitare dhe se për këtë komisioni shtetëror nuk ka pas autorizim. Ai njoftoi se në vitet 2012-2013, z. Meha i ka porosit disa pronarë të Bjelluhës që t'i regjistrojnë pronat e tyre në Komunën e Plavës, të cilëve z. Lajçi u ka thënë se edhe në qoftë se i regjistrojnë këto prona ato prapë do të hetohen dhe do ta shikohen se në cilën datë janë regjistruar, sepse kemi të bëjmë me lidhjet e regjistrimit kadastror që me u punuar pastaj vija e re kufitare me arsye të përputhjes së kadastrave. Z. Lajçi pyeti se nëse vija që është vendos nga komisioni i mëparshëm a është e ratifikuar dhe cila është vija e ratifikuar, duke shtuar se nëse nuk është e ratifikuar atëherë nuk është bërë demarkim, por delimitim.

Vjosa Osmani Sadriu pyeti nëse Mali i Zi ka dëshmi se është përdorur ekskluzivisht kriteri i kadastrës dhe nëse Mali i Zi ka të dhëna kadastrore edhe për pjesën e kontestuar, se a janë ato të dhëna kadastrore apo janë lista poseduese, apo është ndonjë material tjetër që e dëshmon që me kadastrën Mali i Zi e vërteton që ajo pjesë është e tyre. Sa i përket kontrollit efektiv pyeti çfarë nëse ka dëshmi nga vitet e 80 me të cilat dëshmohet se Serbia ka investuar në komunat veriore, atëherë a do të mundet në të ardhmen në përcaktimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë të përdoren argumente të ngjashme për të konstatuar se ai territor është i tyre, pra nëse e përdorin precedentin e njëjtë.

Florim Isufi, sa i përket falsifikimit të hartave, njoftoi se në raport thuhet se mund të konsiderohet si falsifikim, pasi që dikush tjetër e ka bërë një vijë shtesë në hartën origjinale. Sa i përket kontrollit efektiv me dhunë, njoftoi se ai nuk është i efektshëm dhe se kontrolli efektiv çfarë e ka pas Kosova nuk ka pas asnjë kundërshtim nga Mali i Zi, dhe kjo konsiderohet se Mali i Zi është pajtuar dhe ka qenë në dijeni se ai territor është i Kosovës. Ai tha se territori i Kosovës është nga viti 1945 me pjesën shtesë, me vendim zyrtar në vitin 1958-1959 është territor i administruar nga një Qeveri, Kuvend që ka qenë i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Zejnullah Gruda njoftoi se arbitrazhi është institucion zgjedhor, i cili e bën zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të shteteve dhe kushti elementar për me ardhur te arbitrazhi është pajtimi i dy palëve. Z. Gruda tha se Kosovës i shkon në favor një rregull e përgjithshme e të drejtës ndërkombëtare, që për çështjet që prekin nderin e sovranitetin e shtetit, secili shtet ka të drejtë të kërkojë që vetëm me biseda bilaterale me zgjidh dhe kjo duhet t'i thuhet edhe palës malazeze. Ajo që nuk i shkon në favor Kosovës, tha se janë deklaratat e disa prej aktoreve politik të Kosovës, të cilët e kanë ngritur këtë çështje duke thënë se puna është kryer mirë dhe se nuk kemi humbur asgjë. Duke iu referuar pyetjes së deputetit Kurteshi, z. Gruda tha se në publikimin e Akademisë dhe Shkencave të Kosovës të titulluar Monografia për Kosovën e vitit 2011, thuhet se “në pjesën veri-perëndimore Kosova kufizohet me Republikën e Malit të Zi. Linja kufitare ka gjatësi rreth 78.6 km nga tre-kufiri Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi e deri te tre-kufiri Kosovë-Mali i Zi-Serbi linja kufitare shtrihet nëpër kuotat më të larta të bjeshkëve të Nëmura, Bobiqeviq, Moken, Hajll dhe Zhleb. Linja kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi pritet me dy arterie rrugore automobilistike në Qafë Kullë lartësia mbidetare është 1795 m dhe Çakorr 1849 m”, duke shtuar se si mundet kufiri me qenë në Kullë edhe në Çakorr, konform këtij shkrimi, e tash me u zhvendos gati në Sagrinovodë edhe në Kuqishtë e Kosova të mos humb asgjë.

Vjosa Osmani-Sadriu, sa i përket botimit të vitit 2011, tha se akademik Hivzi Islami ka qenë kryetar i Akademisë dhe një ndër recensentët në atë dokument, megjithatë akademik Isa Mustafa është bërë anëtar një vit më vonë, në vitin 2012. Znj. Osmani-Sadriu tha se ne na obligojnë dokumentet që na sjellë Qeveria përpara dhe për momentin e kemi vetëm një marrëveshje, e cila është ri sjellë nga Qeveria Haradinaj, përkundër faktit që nëse kanë qëndrim ndryshe kanë pas për obligim ligjor që në bazë të konventave ndërkombëtare ta njoftojnë Malin e Zi.

Elmi Reçica tha se është e vërtetë që edhe komisioni paraprak edhe ky komision i ka tejkaluar kompetencat, mirëpo nuk e ka bërë për ndonjë qëllim për të krijuar ndonjë tensionim ose për të shtrembëruar diçka. Ai tha se beteja për demarkacionin është betejë për argumente dhe se Komisioni, Parlamenti dhe Qeveria duhet të përgatitën t'i kenë argumentet. Z. Reçica shtoi se deputetët janë para një situatë në të cilën do të duhej të marrim një vendim dhe është më rëndësi që vendimin ta marrim në mënyrë të qetë dhe pa ndonjë presion dhe ndonjë tension.

Vjosa Osmani Sadriu, kërkoi nga komisioni shtetëror, që nëse në ndërkohë kanë material shtesë, t'ia përcjellin komisionit, sepse deri në momentin kur shqyrtohet demarkacioni në seancë plenare ato mund të shfrytëzohen përderisa ato dërgohen zyrtarisht.

Shpejtim Bulliqi tha se çdo gjë që deputetët e kanë në materiale dhe ato që u shpërndanë sot janë dokumentacion nga institucionet tona, nuk janë dokumentacione që janë prodhuar nga anëtarët e komisionit shtetëror. Ai po ashtu tha se edhe komisioni paraprak edhe ky komision e kanë vetëm një detyrë, që ta nxjerrin realitetin dhe ta ndihmojnë vendin që të del nga kjo situatë.

Doruntinë Maloku Kastrati propozoi që seancës t'i dërgohet projektligji pa ndonjë rekomandim të komisionit, meqë kjo çështje është e një rëndësie nacionale dhe se Kryeministri Haradinaj e ka nënshkruar projektligjin, të cilin e kanë sjellë në Kuvend dhe bashkë me të ka sjellë një raport kontradiktor, kundërthënës me projektligjin dhe për raportin e mëparshëm.

Zafir Berisha tha se meqë pozicionet dhe qëndrimet po dihen, pajtohet që komisioni të mos pozicionohet. Kuvendi dihet se si voton dhe kjo çështje duhet të marrë një epilog.

Time Kadrijaj pajtohet që të procedohet projektligji ashtu siç përcaktohen anëtarët e Komisionit, që t'i rekomandohet seancës ta shqyrtojë, por pa rekomandim të komisionit.

Visar Ymeri shprehu mendimin se komisioni do të duhej të diskutonte për rekomandimin që do të jap për këtë projektligj, pra a do të shkohet me versionin që të mos rekomandohet, apo të hedhet në votim. Ai tha se nëse anëtarët e komisionit janë dakord që rekomandimi të jetë "kundër" këtij projektligji, sepse raporti i komisionit shtetëror tregoi që ka pas tejkalim të kompetencës dhe gabime në shënjimin e vijës kufitare. Z. Ymeri kërkoi që rekomandimi që i shkon Kuvendit nga komisioni të jetë thirrje për mos ratifikim të marrëveshjes dhe pastaj seanca pavarësisht rekomandimit të komisionit vendos me shumicë votash.

Vjosa Osmani Sadriu tha se janë dy probleme që lidhen me këtë çështje, problemi i parë është ajo që përmendi deputetja Dërguti, se raporti është preliminar, dhe problemi i dytë është çështja e falsifikimit, e cila është duke u hetuar nga prokuroria. Ajo njoftoi se lidhur me aksidentin e përmendur ka marrë informata se arsyeja se pse Mali i Zi nuk ka ndërhyrë ka qenë për shkak se ditën e aksidentit lartësia e borës ka qenë tepër e madhe. Mund të ndodhë që në ndërkohë të vijë dokumentacion plotësues që mund ta qet komisionin në pozitë të pa lakmueshme. Znj. Osmani Sadriu tha se ka precedentë nga komisionet e tjera parlamentare që i kanë rekomanduar seancës vetëm shqyrtimin e ndonjë çështjeje, pa ndonjë rekomandim.

Zafir Berisha tha se projektligji mund t'i procedohet Kuvendit pa rekomandim, vetëm për shqyrtim. Ai po ashtu tha se deputetët mund edhe të pozicionohen, por nuk dëshiron të përdorët shumica e votës sepse dihen pozicionet dhe paraprakisht dihet edhe rezultati se si ka me qenë në Kuvend. Sa i përket raportit të komisionit shtetëror, tha se meqë është vetëm një raport preliminar komisioni mund t'i rekomandoi Kuvendit që t'ia rikthej Qeverisë, të mos futet në votim dhe të pritët deri në hartimin e raportit përfundimtar.

Visar Ymeri, tha se Komisioni për Punë të Jashtme është Komision Funksional për këtë projektligj dhe se e ka për obligim ta trajtojë atë. Nëse raporti është preliminar atëherë nuk ka nevojë për nguti në komision dhe nëse ka nevojë për informata shtesë nuk kemi pse të vendosim sot, tha z. Ymeri. Shprehu mendimin se në rekomandimin e komisionit që do t'i dërgohet Kuvendit do të duhej të përmendët edhe çështja e tejkalimit të kompetencave nga komisioni i

kaluar shtetëror dhe t'i kërkohet Qeverisë që këtë tejkallim të kompetencave ta konstatojë zyrtarisht. Kjo tha se është detyrë e Kuvendit, e detyra e komisionit është që ta konstatojë këtë tejkallim të kompetencave nga komisioni i kaluar shtetëror. Nëse komisioni është dakord se ka pas tejkallim të kompetencave atëherë duhet t'i tërhiqet vëmendja deputetëve se Komisioni Funkcional ka konstatuar se komisioni i kaluar shtetëror ka tejkalluar kompetencat sa i përket mandati që ka pasur dhe për punën që e ka kryer. Ai propozoi që votimi i projektligjit të bëhet më 15 janar, pasi që pritet të zhvillohen edhe disa procese tjera.

Vjosa Osmani Sadriu tha se pajtohet me deputetin Ymeri që Qeveria do të duhej të deklarohej lidhur me çështjen e tejkallimit të kompetencave. Ajo, po ashtu, tha se deklaratimet politike të Qeverisë po dallohen prej atyre juridike, pasi që në momentin që është votuar marrëveshja e njëjte, pa asnjë ndryshim në Qeverinë e Kosovës, qëndrimi i tyre zyrtar është që janë miratuar tejkallimet e kompetencave. Znj. Osmani Sadriu njoftoi se Qeveria e ka për obligim sipas të drejtës ndërkombëtare, sipas Konventës së Vjenës për traktate, që në momentin që dyshon se ka pas tejkallim të kompetencave ta njoftojë Qeverinë tjetër dhe këtë nuk e ka bërë. Ajo kërkoi që nëse shqyrtohet sot projektligji të mos shkohet me rekomandim për votim apo mos votim, por vetëm me rekomandim për shqyrtim, për shkak të mungesës së informacioneve.

Time Kadrijaj tha se komisioni shtetëror dha sqarime të sakta, se edhe pse është raport preliminar, kjo nuk e ndryshon thelbin përkundrazi e përforcon atë se me këtë marrëveshje Kosova ka humb territore. Detyra e komisionit është ta procedoi tutje këtë projektligj dhe se vendimmarrja i takon deputetëve, por kërkoi që të mos zvarritet puna e t'i kthehet Qeverisë pasi që për këtë çështje ka mjaftë qartësi dhe se kjo është një temë që është duke u trajtuar që 2 vjet. Ajo tha se është kundër kësaj marrëveshje dhe do të votojë kundër edhe në komision edhe në seancë plenare.

Aida Dërguti lidhur me procedimin e këtij projektligji tha se janë dy probleme, njëri është se komisionit i është dorëzuar një raport preliminar dhe tjetri është se sipas mediave, prokuroria është duke e hetuar çështjen e falsifikimit të hartave. Me këto dy elemente tha se është shumë problematike sepse mund ta vejmë Kuvendin në lajthitje, sepse ka dyshime për vepra penale. Ajo shprehu mendimin se votimi i projektligjit duhet të shtyhet deri më 15 janar dhe se ndoshta deri atëherë do ta marrim ndonjë përgjigje nga prokuroria dhe se krijohet mundësi për komisionin shtetëror që ta përfundoi raportin.

Elmi Reçica tha se meqë komisioni nuk po mund të arrij ndonjë konsensus propozoi që kjo çështje të shtyhet për një datë tjetër. Ai ceku se të dy komisionet shtetërore i kanë tejkalluar kompetencat e veta, dhe se në ndërkohë do të vijnë edhe argumente dhe materiale tjera. Ai po ashtu tha se nuk po e caktojmë datën e saktë, sepse pa u mbledh Kryesia e Kuvendit nuk fillon sesioni pranveror, kështu që e presim të mblidhet Kryesia e pastaj të vazhdojmë me punën tonë.

Vjosa Osmani Sadriu, propozoi datën 15 janar, si datë orientuese për mbajtjen e mbledhjes së komisionit, ku përfundimisht vendoset për procedimin e këtij projektligj.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Caktohet mbledhja e radhës së Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, më 15 janar 2018, me ç' rast komisioni do të vendosë për procedimin e mëtejshëm të

Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu